



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr. 415/13

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me sekretaren juridike Luljeta Susuri, në kontestin e paditësit H. M. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. N. Q. nga Prizreni, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës distrikti në Prizren, të cilin e përfaqëson i autorizuar O. K. nga Prishtina për shkak të anulimit të vendimit dhe kthimin në vendin e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 13.07.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit H. M. nga Prizreni, me anë të së cilës ka kërkuar që të anulohen vendimet e KEK-ut nr. .../. të datës 26.03.2013 dhe të datës 10.04.2013 si dhe të obligohet e paditura KEK-u distrikti në Prizren që paditësin ta kthejë në vendin e punës sipas kontratës nr. të datës 01.09.2011 duke ja njohur të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që nga dita e ndërprerjes dhe shkëputjes së kontratës si dhe të kompenzojë të ardhurat personale të gjitha këto në afat prej 7 nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë”, **si tërësisht e pa bazuar.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë ka parashtruar padi për anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës kundër të paditurit Korporata Energjetike e Kosovës distrikti në Prizren.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më datën 13.07.2015 i autorizuari i paditësit av. N.Q. nga Prizreni në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore është vërtetuar se vendimi i të paditurës nr. .../. i datës 26.03.2013 për shkëputjen e kontratës së marrëdhënies së punës është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e brendshme të paditurës për procedurën disiplinore. Dëshmitarët e dëgjuar në këtë çështje gjatë shqyrtimit kryesor kanë vërtetuar faktin se paditësi në një kohë të gjatë nuk ka jetuar dhe banuar në fshatin, ku edhe ka qenë e regjistruar shifra e konsumatorit për të cilën është ngarkuar me procedurë disiplinore paditësi. Gjykata duhet të marrë në konsiderat dhe të vlerësoi faktin se paditësi që nga viti 1999 ka qenë i punësuar tek e paditura dhe në bazë të kartelës së punëtorit e cila është administruar si provë me nr. shihet se nuk ka pas asnjëherë asnjë vërejtje apo masë disiplinore të shqiptuar.

E tërë procedura disiplinore është bazuar në raportin konfidencial të auditimit të brendshëm të cilit raport nuk i janë bashkangjitur provat formulari B dhe procesverbali nr. i përpiluar nga auditimi operativ. Me rastin e fillimit të procedurës disiplinore nuk kanë marrë pjesë personat e domosdoshëm, përfaqësuesi i sindikatës anëtarë i të cilës është paditësi, ndërsa arbitër ka qenë drejtori i distriktit V. S. i cili vendimin e sulmuar me padi nuk e ka marrur në mënyrë të pavarur por sipas udhëzimeve të auditimit të brendshëm dhe në këtë mënyrë janë shkelur dispozitat e procedurës disiplinore të cilat dispozita janë të përmbledhura në rregulloren operacionale të distrikteve. Provat e administruara kanë vërtetuar se mungon shkelja e detyrave të punës siç është përcaktuar me nenin 7 par.7.1 etj, të kondit disiplinor nr.2, dhe në mungesë të fakteve të vërtetojnë shkeljen e supozuar, e tërë procedura disiplinore është e kundërligjshme. E paditura u thirr në faktin se gjykata ka për obligim të vërtetoj shkeljet procedurale të procedurës disiplinore dhe jo gjendjen faktike, konsideroj se ky konstatim nuk qëndron, sepse gjykata ka për obligim të ofroj mbrojtje ligjore për të drejtat e punëtorit dhe mbrojtjet nga abuzimet që mund të bëjnë organet menagjuese, duke shqiptuar masat disiplinore pa ekzistimin e ndonjë shkelje eventuale, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret. Bazuar edhe në provat materiale dhe në faktin se sipas rregullave të brendshme të të paditurës për shkeljet eventuale qofshin ato të rënda apo të lehta duhet të shqiptohet vërejtja me paralajmërim për shkeljen e kontratës, ndërsa në rastin konkret është vepruar duke caktuar masën më të rëndë e që është në kundërshtim me rregullat e brendshme të paditurës, i propozoj gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë. Varësisht nga vendimi i gjykatës që tani paralajmërojmë ankesë për shkak të refuzimit të kërkesës për administrimin e provave. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë shumën prej 100 € në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 405 për tri seancat e mbajtura gjithsej shumën prej 505 €, si dhe taksën në shumën prej 15 €.

I autorizuari i paditurës në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: se nga administrimi i provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e sidomos me deklarin e dëshmitarëve të ftuar të cilët kanë bërë auditimin dhe kanë gjetur shkelje të natyrës së tillë e cila ka ndikuar që paditësit ti shkëputet kontrata e punës dhe këtu nuk ka dilem se e paditura ka vepruar konform pikës 11 të Kontratës së punës, ku shkëputja e kontratës së punës i është bërë në përputhje me 67 deri në 71 dhe 76 të Ligjit të Punës, konform kësaj është udhëhequr edhe procedura disiplinore, çka dëshmohet edhe nga procesverbali nr. ... të dt.26.03.2013 e çka është me rëndësi ku vetë paditësi deklaron dhe përgjigjet se nuk kam bërë kërkesë me shkrim por vetëm gojarisht i kam njoftuar zyrtarët e këtij subjekti për shkak se është dashtë të bëhet borxhi në 0. Nuk është kontestuese se paditësi ka paguar rrymën për atë njehsor ku zyrtarët e auditit kanë gjetur parregullsi dhe pyetjet e punëmarrësit se a paguani rrymën për këtë njehsor, punëmarrësi përgjigjet se po se edhe më tutje e bënë pagesën. Ky fakt është i rëndësishëm, edhe për gjykatën në rastin e vendosjes nga se kontestohet deklarata B e cila apo sipas të cilës paditësi ka qenë i obliguar të bëjë pagesën e energjisë elektrike. Nuk është kontestuese se paditësi ka qenë i ngarkuar me dy njehsor dhe ate njëri në shtëpinë e banimit kurse tjetri në pikën e karburantit. Të gjitha këto sqarohen në raportin konfidencial të auditit të brendshëm e që edhe raporti i cili është kërkuar i njëjti është bërë dhe i është lënë një kopje paditësit. Nuk ka met dilem se paditësi e ka keqpërdorur energjinë elektrike dhe ajo

është vërtetuar me fletëparaqitjen e formularit A të procedurës disiplinore shkeljet e raportuara të A. X. ku në detale janë përshkruar shkeljet nga të gjitha këto nuk ka dilem se vendimet e të paditurës janë të ligjshme dhe të marrura në procedurën e regullt ligjore andaj pretendimet e të autorizuarit të paditësit se ka shkelje procedurale me rastin e vendosjes nuk qëndrojnë nga se në ftesën e punëtorit për pjesëmarrje në komisionin disiplinor është njoftuar se ka të drejtë që të marrë edhe përfaqësuesin e sindikatës çka një të drejtë të këtillë e garanton edhe ligji. Andaj mbi këtë bazë i propozoj gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: kontratën e punës nr./. , kontratën e punës nr./. , fletëparaqitja nr. ... të datës 14.03.2013, proceverbali mbi seancën dëgjimore nr. ... të datës 26.03.2013, vendimin nr. .../. të datës 26.03.2013, kërkesën nr. të datës 27.03.2013, vendimin nr. të datës 10.04.2013, kartela e punëtorit të datës 20.05.2015, raportin e auditimit të brendshëm raporti konfidencial janë dëgjuar dëshmitarët G. J., R. M. , B. Z. dhe L. S. .

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet si e **pa bazuar**.

Me leximin e kontratës së punës nr./. , gjykata ka vërtetuar se është lidhë marrëdhënia e punës në mes të punëdhënësit KEK-u dhe punëmarrësit H. M. në kohë të pacaktuar nga data 01.09.2011 derisa njëra nga palët nuk e shkëput kontratën e punës.

Me leximin e kontratës së punës nr./. , gjykata ka vërtetuar se është lidhë marrëdhënia e punës në mes të punëdhënësit KEK-u dhe punëmarrësit H. M. në kohë të pacaktuar nga data 01.12.2012 derisa njëra nga palët nuk e shkëput kontratën e punës.

Me leximin e fletëparaqitjes nr. ... të datës 14.03.2013, gjykata ka vërtetuar se është propozuar që kundër punëmarrësit H. M. të fillohet dhe zhvillohet procedura disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë së tij për shkak të dyshmit të bazuar të shkeljes së detyrave të punës nga neni 7.7.1 pika (f) vjedhja e qfarëdo asetit të KEK-ut me të cilat operon apo i ka në posedim të tij apo dhënia e ndihmës apo nxitjes së personave tjerë për të vjedhur asetet.

Me leximin e proceverbalit nr.547 të datës 26.03.2013, gjykata ka vërtetuar se është zhvilluar procedura disiplinore ndaj paditësit dhe procedurën e ka udhëhequr arbitri – drejtori i distriktit në prezencë të përfaqësuesit nga departamenti i BNJ.

Me leximin e vendimit nr. .../. të datës 26.03.2013, gjykata ka vërtetuar se punëmarrësit H. M. i'u është shkëputur kontrata e punës prej datës 26.03.2013 pa periudhë paralajmërimi njoftimi.

Me leximin e kërkesës për rishqyrtim nr. të datës 27.03.2013, gjykata ka vërtetuar se nga punëmarrësi është ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Drejtorit Ekezekutiv të Rrjetit me propozim që vendimi nr. të datës 26.03.2013 të anulohet si i paligjshëm dhe punëtori H. M. të kthehet në vendin e punës.

Me leximin e vendimit nr. të datës 10.04.2013, gjykata ka vërtetuar se është refuzuar si e pabazë ankesa e punëmarrësit H. M. e parashtruar kundër-vendimit të Drejtorit të distriktit të Prizrenit nr. ... të datës 26.03.2013 me të cilin i është shkëputur kontrata e punës.

Me leximin e raportit konfidencial të auditimit të brendshëm rasti nr. –.. -... , gjykata ka vërtetuar se është bërë auditimi i punonjësve të KEK-ut mbi shpenzimet e energjisë elektrike nga data 09.01.2013 deri më datën 06.02.2013 dhe është konstatuar kjo gjendje keqpërdorimi i energjisë elektrike nga punëtori i KEK-ut H. M. sipas së cilës punonjësi i larcekur e ka plotësuar deklaratën B për shifrën DPZ me nr. të njesorit elektrik në emër të A. M. dhe deri më sot shpenzimet e energjisë elektrike për këtë shifër, i njëjti i ka paguar përmes pagës. Ekipi i auditimit operativ pas verifikimit të datës 18.01.2013 ka konstatuar se në këtë pronë ishin dy objekte banimi. Në objektin ku ishte i vendosur njesori elektrik nr. prezent gjatë kontrollit ishin prindërit e punonjësit, bashkëshortja dhe djali i tij etj....., pas të gjitha këtyre veprimeve njesor është dërguar për kalibrim në Qendrën e Kalibrimit dhe më datën 08.02.2013 pas verifikimit në Qendrën e kalibrimit është kostataur se njesori elektrik pllombat shtetërore i ka të produesit Iskra, të cilat janë të falsifikuara, numëruesi i njesorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishjes së numrave në numrator etj.

Nga leximi i kartelës së punëtorit, gjykata ka vërtetuar se në këtë kartelë jepen të dhëna personale të punëtorit sa i përket dhe përvojës së punës në KEK.

Dëshmitari G. J. nga Prizreni ka theksuar: se paditësi nga viti 1999 ka qenë punëtori i KEK, dhe që nga ai vit H. M. ka banuar në Prizren, në banesën e ish TMK, në atë kohë kur unë kamë shkuar për ta çkyqyr njesorin, njesori ka qenë në emër të vëllait të tij R. M. . H. e ka pasur edhe një njesor të vendosur në një pikë karburanti që është pronë e tij, e di që edhe aty ka pasur njesorin në emrin e vetë dhe mbi atë pikë të karburantit ka pasur dhoma familjare.

Dëshmitari R. M. nga fshati ka theksuar se me sa kam unë njohuri e kanë larguar kushëririn prej punës për shkak të vjedhjes së rrymës elektrike, unë deklaroj se kushëri im nuk ka qenë duke jetuar aty dhe mendoj se nuk ka përgjegjësi për atë njesor.

Dëshmitari B. Z. nga fshati ka theksuar se: raportin për auditim e kemi përgatitur me kolegun tim L. S. , me urdhëresë të drejtorit të auditimit të KEK-ut në atë kohë M. H. . Pas analizave që janë bërë i kemi shiquar shpenzimet dhe ato që kanë qenë më pak të ulëta i kemi listuar dhe i kemi bërë kontrolle në teren.

Për legjislacion ka qenë i paraparë që çdo punëtor i KEK- me nënshkru kontratë që hargjimet mi pagu dhe pikën matëse me deklaruar. Ndër punonjësit tjerë që kemi qenë në kontrolle, kemi qenë edhe te kolegu H. për ti verifikuar shpenzimet e energjisë. Me ne ka qenë L. S. , A. B. . Kur ne kemi hyrë në shtëpi, kemi vërejtur se janë dy shtëpi të

banimit, në shtëpinë e vjetër ka qenë shifra e njehsorit që e kemi kërkuar për kontroll, njehsori ka qenë brenda në dhomë i vendosur, afër njehsorit elektrik ka qenë i vendosur një ndrërprerës 0 -1-2 dhe në momentin e kontrollit njehsori ishte në pozitën 1 dhe shpenzimet njehsori i njësojete, ndërsa me kalimin e ndërpresit në pozitën 2 disku ndalej në njehsor ndërkaq rrymë kishte në objekt. Kjo edhe vlen të theksohet se edhe me dt.08.02.2013 njehsorët i kemi dërguar për verifikim dhe kalibrim në laborator. Ndërkaq komisioni ka konstatuar se bllobat shtetërore janë të falsifikuara, edhe numratori është i prekur brenda.

Dëshmitari L. S. , nga fshati Komuna e Obiliqit ka theksuar se: në vitin 2013 në fillim të këtij viti me kërkesë të drejtorit të auditimit janë kontrolluar njehsorët elektrik të punëtorëve të KEK_ut në të gjitha distriktet në Kosovë. Janë kontrolluar konsumatorët - punëtorët e KEK, që faturat mujore të shpenzimeve të energjisë elektrike që kanë qenë nën vlera minimale. Në distriktin e Prizrenit, janë kontrolluar disa punëtor të këtij distrikti në mes e të cilëve ka qenë edhe paditësi H. M.. Gjatë kontrollës te njehsori elektrik kemi konstatuar se para njehsorit elektrik gjendjet një ndrërprerës 0-1-2 përmes të cilit konsumatori ka keqpërdorur energjinë elektrike. Kemi përpiluar procesverbalin për këtë dhe të njëjtin proces e kemi dorëzuar në distriktin në Prizren. Diçka tjetër nuk kamë çka të deklaroi:

Në nenin 70 të Ligjit të Punës Nr.03/L-2012, i cili ka hyrë në fuqi më datën 16.12.2010 përcakton rastet e ndrërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit , ku ndër të tjera paragrafi. 1.4.1 dhe 1.4.2 të nenit 70 thotë se “punëdhënësi mund të ja ndërprejë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit a) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit dhe b) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës. **Ndërsa paragrafi 1.6 i po këtij neni përcakton rastet e ndrërprerjes së kontratës së punës pa paralajmërim në rastet kur a) i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjellje më pak serioze ose shkeljës së detyrimeve.** Në kontratat e punës së të paditurës në nenin 11 të saj shprehimisht rregullohet çështja e ndrërprerjes së kontratës së punës ku thuhet se “Kjo kontratë e punës mund të shkëputet në përputhje me nenin 67 deri në 71 dhe 76 të Ligjit të Punës në Kosovë, dispozitat e këtyre neneve gjithashtu jananë të reflektuara në Kodin e Punës së KEK-ut”.Duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërjgjyjtëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartëcituara, e njëjta duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Kjo ngase siq edhe u cek më lartë, me dispozitat e Ligjit të Punës, është përcaktuar qartë se kur mund të shkëputet kontrata e punës pa paralajmërim andaj edhe nga vendimi i të paditurës shihet qartë se kontrata e punës punëmarrësit i është ndrërprerë për shkak të shkeljës së rëndë të detyrave të punës të parapra edhe në nenin 7 par.7.1 të Kodit Disiplinor të paditurës (vjedhja e qfarëdo asetit të KEK-ut me të cilat operon apo i ka në posedim të tij apo dhënia endihmës apo nxitjes së personave tjerë për vjedhjen e energjisë elektrike. Nuk qëndrojnë pretendimet e të autorizuarit të paditësit se sipas rregullave të brendshme të paditurës për shkeljet eventuale qofshin ato të rënda apo të lehta duhet të shqiptohet vërejtja me paralajmërim për shkëputjen e kontratës, ndërsa në rastin konkret është vepruar duke caktuar masën më të rëndë e që është në kundërshtim me rregullat e brendshme të paditurës, ngase sipas nenit 70 par. 1.6 thuhet se punëdhënësi mund t’ia ndërpres kontratën e punës të punësuarit pa periudhë e kërkuar të paralajmërimit të ndrërprerjes atëherë kur a) i punësuarit është fajtor për përsëritjen e në sjellje të keqe më pak serioze ose të shkelje së detyrimeve. Edhe sipas kodit disiplinor të paditurës në nenin 10.21 është paraparë se

“Nëse arbitri mendon se punëmarrësi shkelës i ndëshkuar ka kryer një shkelje të rëndë masa disiplinore duhet të jetë shpërbërje e kontratës së punës. Nuk qëndrojnë as pretendimet se gjatë mbajtjes se seancës disiplinore nuk ka qenë prezent përfaqësuesi i i sindikatës ngase këtë mund ta kishte ftuar vetë paditësi me rastin e njoftimit të tij për në seancën disiplinore ka qenë e drejtë e tij që ta ftoj një përfaqësues të sindikatës anëtarë i të cilit ka qenë vetë paditësi. Andaj nuk ka shkelje të procedurave për këtë arsye edhe vendimi i të paditurës ka qenë i ligjshëm. Gjykata e refuzojë propozimin e të autorizuarit të paditësit për nxjerrjen e provave zyrtarisht nga gjykata formularin B dhe proceverbalin të përpiluar nga auditimi operativ për shkak se barra e propozimit dhe të parashtrimit të provës bie mbi palët ngase është procedurë kontesimore dhe të gjitha palët propozojnë provat e tyre për vërtetimin e fakteve relevante që shkojnë në favorin e tyre. Gjykata ia fali besimin provave materiale fletëparaqitja nr. ... të datës 14.03.2013, proceverbali mbi seancën dëgjimore nr. ... të datës 26.03.2013, vendimin nr. .../ të datës 26.03.2013, kërkesën nr. të datës 27.03.2013, vendimin nr. të datës 10.04.2013, kartela e punëtorit të datës 20.05.2015, raportin e auditimit të brendshëm si dhe dëshmisë së dëshmitarëve G. J. , B. Z. dhe L. S. ngase dëshmitë e veta i bazojnë në lidhje me kontrollat që janë bërë të paditësit rreth shpenzimeve të energjisë elektrike si dhe rreth auditimit të bërë në lidhje me këtë rast.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.4 të LPK-së, pasi që asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
C.nr.415/13, datë 13.07.2013

Sekretarja juridike
Luljeta Susuri

Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit të të njëjtut, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.